



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:033300

Datë: 27.03.2025

Numri i dokumentit: 07057988

P.nr.25/2024

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit P.G nga Vushtrria, të cilin sipas autorizimit e mbron av. Xhafer Maliqi, për shkak të veprës penale *Lëndimi i lehtë trupor* nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i ngarkuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1031/20, të datës 01.10.2021, duke vendosur sipas kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hedhjen e aktakuzës, të paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit P.G, av.Xhafer Maliqi, në mbështetje të neni 243 dhe 244 par. 3 dhe nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, me datë 27.03.2025, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET kërkesa për hedhjen e aktakuzës e mbrojtësit të të pandehurit P.G, av.Xhafer Maliqi, ashtu që:

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1031/20, e datës 01.10.2021 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit P.G, nga i ati B..., e ëma H..., e vajzërisë P..., i lindur me ..., me vendbanim në Vushtrri, rr. "...", nr..., tani me vendbanim të përkohshëm në Gjermani, me numër personal ..., për shkak të veprës penale *Lëndimi i lehtë trupor* nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Pala e dëmtuar R.B udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

A r s y e t i m

Historiku i çështjes

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1031/20, të datës 01.10.2021, ndaj të pandehurit P.G nga Vushtrria, të cilin sipas autorizimit e mbron av. Xhafer Maliqi, për shkak të veprës penale *Lëndimi i lehtë trupor* nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, pas sigurimit të prezencës së të pandehurit ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.08.2024, në të cilën i pandehuri P.G është deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Andaj, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë njoftuar se brenda afatit prej 30 ditësh mund të paraqesin kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

Mbrojtësi i të pandehurit P.G, av. Xhafer Maliqi, me datë 09.09.2024 ka paraqitur kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës ndaj të mbrojturit të tij.

Gjykata, me datë 11.11.2024 i ka dërguar thirrje për plotësimin e aktakuzës PP.II.nr.1031/20, të datës 01.10.2021, Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, në të cilën është kërkuar nga Prokuroria Themelore Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, që në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së thirrjes t'a plotësoj aktakuzën, duke i'a bashkangjitur edhe marrjen në pyetje të të pandehurit nga prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës.

Pretendimet e palëve

Në kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës mbrojtësi i të pandehurit P.G, av.Xhafer Maliqi, ndër të tjera ka theksuar se në këtë çështje penale është marrë aktvendimi mbi fillimin e hetimeve pasi që vepra penale është e ndëshkueshme mbi tri vite, por që në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se përpos këtij aktvendimi organi i akuzës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zhvillimin e hetimeve sipas këtij aktvendimi, madje prokuroria aktakuzën e

mbështetë në prova të cilat i ka nxjerrë policia, duke shtuar se as i pandehuri e as dëshmitarët e propozuar në aktakuzë, nuk janë dëgjuar në prokurori, para ngritjes së aktakuzës, e të gjitha këto prova janë të papranueshme ngase ato nuk paraqesin bazë të aktikulueshme dhe si të tilla gjykata duhet ti çmojë thelbësisht të pambështetshme.

Kërkesën për hudhje të aktakuzës, mbrojtja e mbështetë në faktin se aktakuza e ngritur është akt i kundërligjshëm ngase është ngritur pa u marrë në pyetje i pandehuri nga ana e prokurorit të shtetit apo policit hetues të autorizuar siç parashihet në nenin 151 të KPP-së, i zbatueshëm në kohën e zhvillimit të hetimeve. Andaj mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të merr aktvendim për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale ndaj të pandehurit, për veprat penale për të cilat akuzohet.

Një kopje e kundërshtimit të provave dhe kërkesës për hudhje të aktakuzës, i është dërguar Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, mirëpo prokurori i shtetit nuk ka paraqitur përgjigje.

Vendosja e gjykatës lidhur me kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhje të aktakuzës

Duke u nisur nga gjendja e përshkruar më lart, gjykata, pas vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se në rastin konkret duhet hedhur aktakuzën, për këto arsyeje:

I pandehuri P.G, sipas aktakuzës së prokurorisë PP.II.nr.1031/20, të datës 01.10.2021, akuzohet për kryerjen e veprës penale *Lëndimi i lehtë trupor* nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën vepër, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës parashihet dënim me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vite. Duke pasur parasysh dënimin e paraparë për veprën penale objekt i kësaj aktakuze, zbatimi i hetimit nga prokurori i shtetit është i domosdoshëm, ashtu siç parashihet me nenin 99 par.1 të KPPRK-së i cili parasheh “*Kur policia apo ndonjë agjenci tjetër qeveritare bën kallëzim tek prokurori i shtetit për dyshim të arsyeshëm për vepër penale, prokurori i shtetit mund të fillojë fazën e hetimit të procedurës penale sipas nenit 100 të këtij Kodi.*” ashtu që, nga shkresat e lëndës gjykata, konstaton, se prokurori i shtetit me datën 29.10.2020 ka nxjerr aktvendimin për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit P.G.

Me nenin 149 paragrafi 1, të Kodi të Procedurës Penale është përcaktuar se “*Përveç rasteve të parapara në nenin 234, paragrafi 2 të këtij Kodi, i pandehuri duhet të merret në pyetje nga*

prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës. Nëse i pandehuri hetohet për veprë apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është deri në tre (3) vjet burgim, mjafton që i dyshuari apo i pandehuri të jetë marrë në pyetje në polici me autorizim të prokurorit të shtetit.”, ashtu që, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se i pandehuri nuk është marrë fare në pyetje nga prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës, kështu që, duke pasur parasysh dispozitën e mësipërme, dhe atë se për veprën për të cilën akuzohet i pandehuri mund të shqiptohet dënim me burgim prej 6 muaj deri në 5 vite (pra, mund të shqiptohet dënim me burgim me mbi tri vite) gjykata vlerëson se mos marrja në pyetje dhe mosdhënia e mundësisë të pandehurit për t’u deklaruar në lidhje me veprën penale për të cilën është ngarkuar, në procedurë paraprake (fazën e hetimeve), e po ashtu edhe në nenin 151 të KPPK-së i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është pengesë e pakapërcyeshme dhe pa mëdyshje shkelje e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e po ashtu në kundërshtim të plotë me nenin 9 të Kodi të Procedurës Penale të Kosovës, pra me parimin e barazisë së palëve në procedurë, pasi që të pandehurit nuk i është dhënë fare mundësia që të deklarohet lidhur me akuzën ndaj tij.

Për më tepër një veprim i tillë i prokurorisë është edhe në kundërshtim të plotë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në mënyrë decisive, në nenin 6 parasheh të drejtën për një proces të rregullt, e që sipas gjykatës, mos marrja në pyetje-mos dhënia e mundësisë për t’u deklaruar të pandehurit gjatë fazës hetimore (para ngritjes së aktakuzës) pa dyshim që cenon rregullsinë, pavarësinë dhe paanshmërinë e procesit në zhvillim.

Po ashtu, sipas gjykatës, gjatë hetimeve nuk është vepruar konform nenit 129 par.1 të KPPK-së në të cilin parashihet *“Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit thërret dëshmitarët, viktimat, ekspertët dhe të pandehurin apo të pandehurit për të dhënë deklaratë në procedurë paraprake”* dhe par. 6 të nenit të lartcekur, ku parashihet *“Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklaratë në procedurë paraprake. Kopje e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës.”* ashtu që, sipas shkresave të lëndës, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij eventual nuk janë ftuar për të dhënë deklaratën në procedurë paraprake (hetimore), gjegjësisht nga dita e marrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve deri në ditën e ngritjes së aktakuzës ka kaluar më shumë se shtatë (7) muaj dhe sipas vlerësimit të gjykatës prokuroria nuk ka zbatuar fare fazën e hetimeve në këtë çështje penale, mirëpo vetëm është marrë një aktvendim

për fillim të hetimeve sa për të përmbushur obligimin ligjor për ndërmarrjen e një veprimi të tillë. Për më tepër, në shkresat e lëndës nuk ka prova fare, nëse është ftuar për t'u marrë në pyetje në procedurë paraprake (hetimore) as i dëmtuari, ndonjë dëshmitarë apo ekspert. Pra, gjatë fazës së hetimeve, nuk është ndërmarrë asnjë veprim hetimor nga prokurori i shtetit sipas nenit 101 par.1 i KPPK-së ku është përcaktuar *“Gjatë fazës së hetimit, prokurori i shtetit çmon jo vetëm rrethanat dhe provat fajësuese por edhe ato shfajësuese, dhe siguron marrjen e provave të cilat mund të mos jenë të mundshme në shqyrtim gjyqësor.”* dhe par. 2 i nenit të lartcekur, në të cilin është përcaktuar se *“Qëllimi i hetimit është që të mbledhen provat dhe të dhënat e nevojshme për të vendosur nëse duhet të ngritet aktakuza apo të pushohet procedura dhe për të mbledhur prova të cilat mund të jetë e pamundshme apo e vështirë që të riprodhohen në shqyrtim gjyqësor.”* ashtu që, sipas vlerësimit të gjykatës, qëllimi i hetimit nuk arrihet vetëm me nxjerrjen e një aktvendimi për fillim të hetimeve, por me veprime konkrete hetimore nga prokuroria (marrja në pyetje-deklarata e të pandehurit, të dëmtuarve, dëshmitarëve etj.), pra, as ky standard nuk është përmbushur nga prokuroria.

Megjithëse, sipas shkresave të lëndës, përkatësisht procesverbalit mbi marrjen në pyetje të dyshuarit, i përpiluar në Stacionin Policor në Vushtrri me datë 08.08.2020, konstatohet se është intervistuar i akuzuari (në cilësinë e të dyshimit) në kuptim të nenit 73 par. 3 të KPPK-së, në të cilin përcaktohet se *“Policia ka të drejtën e intervistimit të personave që mund të jenë të dyshimtë për kryerje të një vepre penale, por së pari duhet të informojë të dyshuarin për veprat penale, për të cilat dyshohet se ai i ka kryer dhe për të drejtat e tij, në bazë të nenit 125, paragrafi 3...”*, mirëpo sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në kohën e intervistimit të të pandehurit nga policia, ka qenë faza para-hetimore, ngase përkufizimi i nenit 19 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së, përcakton se *“I dyshuar - personi për të cilin policia ose prokurori i shtetit dyshojnë se ka kryer veprë penale, por ndaj të cilit nuk është filluar hetim”*, derisa hetimet kanë filluar me datë 11.02.2021, dhe pas fillimit të hetimeve me aktvendim formal, nuk është intervistuar i pandehuri nga ana e Prokurorisë dhe nga Policia e Kosovës, përkundër dispozitave impertative të lartë-cituara.

Për më tepër, edhe praktika gjyqësore veçse është konsoliduar në këtë aspekt, pasi në gjendje faktike identike, pra në raste identike, me aktvendimet e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, P.nr.14/22, të datës 05.12.2022, dhe atë P.nr.202/23, të datës 25.01.2024, kjo Gjykatë e ka hedhur aktakuzën dhe pushuar procedurën penale për të njëjtat arsye, ndërsa me

aktvendimet e Gjykatës së Apelit, PN.nr.1353/22 i datës 10.01.2023 dhe PN.nr.381/24, të datës 20.03.2024 me të cilët janë refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe janë vërtetuar aktvendimet e kësaj gjykate. Po ashtu edhe në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML.nr.343/2023 i datës 22.07.2024, është ndërtuar praktika lidhur me rastet e natyrës së njëjtë.

Nga të gjitha gjetjet e mësipërme, gjykata ka ardhur në përfundim se një akt akuzues në këtë gjendje, me të gjitha të shkeljet ligjore të identifikuara më lart, dhe mungesën e veprimeve hetimore, e rrjedhimisht provave, nuk mund të vazhdoj të shqyrtohet, e aq më pak të nxirret ndonjë vendim meritator nga gjykata lidhur me të njëjtin, e kjo edhe në mbështetje të parimit të ekonomizimit dhe të gjykimit në kohë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në mbështetje të nenit 243 par.3 dhe nenit 244 par. 3 dhe nenit 248 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA VUSHTRRI

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.25/2024, datë 27.03.2025

Zyrtarja ligjore

Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Naim Rekalju

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 10 (dhjetë) ditësh prej ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.